ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: *(KUVENDI KOMUNAL - ZUBIN POTOK)*

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: *(641-26-9552-2-2-1)*

Sa i përket tenderit për *(Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal)*

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Traffiks va SH.P.K
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Radovan Zogoviq . B1, C3, Hyrja 2 nr 27
(Adresa)

PRISHTINË *(Vendi)* **10 000** *(Kodi postar)*

048/191919 *(Numri Telefonit)* _____ *(Numri i Faks-it)*

Visar Muriqi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@traffiks-ks.com
(Adresa elektronike)

17.11.2026
(Data e parashtrimit të ankesës)

_____
(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

_____
(Adresa e plotë)

_____ _____
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____
(Adresa elektronike)

_____ _____
(Data e parashtrimit të kërkesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

B05 Njoftim për Kontratë	*29.10.2026*
Kërkesë për Ri-shqyrtim	
Vebdim mbi pezullim	*02.11.2026*
Përgjigje ndaj kërkesës	*03.11.2026*
Kërkesë për Sqarime	*09.11.2026*
Përgjigje ndaj kërkesës për sqarim te cilën e kan trajtuar si ankese	*13.11.2026*
Kërkesë për Ri-shqyrtim	*14.11.2026*
Parshtrim i Ankeses ne OSHP	*17.11.2026*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Nuk kemi marrë pjesë në procesin e hapjes së tenderëve, pasi që deri në momentin e plotësimit të këtij dokumentacioni, hapja e tenderëve ende nuk është realizuar. Hapja e tenderit parashiet te jet 18.11.2026

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

*Në kuadër të aktivitetit të prokurimit me titull **"Sinjalizimi horizontal dhe vertikal"**, me nr. të prokurimit **641-26-9552-2-2-1**, pranë Kuvendit Komunal – Zubin Potok, më datën **09.11.2026** kemi parashtruar **Kërkesë për Sqarime** lidhur me kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.*
*Më datën **13.11.2026**, kemi pranuar përgjigjen e Autoritetit Kontraktues ndaj kërkesës sonë për sqarime. Mirëpo, në vend që t'i trajtonte pyetjet tona si kërkesë për sqarime dhe të ofronte përgjigje konkrete, AK-ja e ka trajtuar atë si kërkesë për rishqyrtim, duke i cilësuar pyetjet tona si "pretendime ankimore" dhe duke i refuzuar si të pabazuara.*
Përveçse nuk kemi marrë sqarimet e kërkuara, kjo mënyrë e trajtimit të kërkesës sonë ka ndikuar drejtpërdrejt në ushtrimin e të drejtave tona ligjore, pasi përgjigjja e dhënë në mënyrë të gabuar, pas pesë ditësh pritjeje, na ka vënë në pozitë të tillë që të mos mund ta ushtronim në kohë të drejtën për të parashtruar kërkesë për rishqyrtim ndaj çështjeve të ngritura. Kjo rrethanë ngre dyshime serioze se trajtimi i tillë nuk ka qenë i rastësishëm, por ka pasur për pasojë humbjen e së drejtës sonë për të shfrytëzuar këtë mjet juridik brenda afatit ligjor.
*Përkundër kësaj, kemi parashtruar **Kërkesë për Rishqyrtim** pranë Autoritetit Kontraktues, mirëpo deri në momentin e parashtrimit të kësaj ankese në OSHP, nuk kemi pranuar asnjë përgjigje apo vendim nga AK-ja lidhur me kërkesën tonë për rishqyrtim.*
Si dëshmi të rrethanave të lartcekura, bashkëngjitur kësaj ankese paraqesim kërkesën për sqarime të datës 09.11.2026, përgjigjen e AK-së të datës 13.11.2026 dhe kërkesën për rishqyrtim të parashtruar pranë AK-së, për të cilën ende nuk kemi pranuar përgjigje.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues, që nga publikimi i Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit, ka shkelur dispozitat e legjislacionit të prokurimit publik, si në vijim:

- **LPP – Neni 7, paragrafët 1, 2 dhe 3:** Barazia në Trajtim dhe Jo-Diskriminimi, për shkak të kërkesave profesionale dhe teknike që mund të kufizojnë konkurrencën dhe të favorizojnë operatorët ekonomikë të fushës së ndërtimtarisë, ndonëse objekti i kontratës është sinjalizimi horizontal dhe vertikal.
- **LPP – Neni 27, paragrafët 1 dhe 4:** Dosja e Tenderit, për shkak të mungesës së informatave dhe dokumentacionit të nevojshëm për përshkrimin e plotë të objektit të kontratës, përfshirë Aneksin 1 – Specifikacionin Teknik, nëse konfirmohet mungesa e tij në dosjen e publikuar.
- **Rregullorja Nr. 001/2022, e ndryshuar me Nr. 002/2024 – Neni 17.12, 17.17 dhe 17.22:** Për plotësimin e dosjes me informatat dhe dokumentacionin përkatës, si dhe ndalimin e kërkesave që kufizojnë konkurrencën apo diskriminojnë operatorët ekonomikë.
- **LPP – Neni 28, paragrafi 2 dhe Rregullorja Nr. 001/2022 – Neni 19.1, 19.3, 19.4, 19.14 dhe 19.15:** Për përcaktimin e specifikimeve teknike të qarta, precize dhe jodiskriminuese, të cilat duhet të jenë në përputhje me natyrën dhe qëllimin e kontratës.

- **Udhëzuesi Nr. 002/2024 – Pikat 5.1 dhe 5.2:** Për sigurimin e qasjes së barabartë dhe shmangien e pengesave të paarsyeshme për konkurrencën përmes specifikimeve teknike.
- **LPP – Neni 51, paragrafët 1 dhe 3 dhe Rregullorja Nr. 001/2022 – Neni 25.17:** Për përcaktimin e kritereve të përzgjedhjes që duhet të jenë të qarta, drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës.
- **Udhëzuesi Nr. 002/2024 – Pika 8.3:** Për përcaktimin e drejtë dhe proporcional të kritereve minimale të kualifikimit.
- **LPP – Neni 53, paragrafët 4, 5 dhe 6 dhe Rregullorja Nr. 001/2022 – Neni 24.1, 24.4, 24.5 dhe 24.7:** Për mosdhënien e sqarimeve konkrete lidhur me çështjet e ngritura nga OE, si dhe mosshqyrtimin e duhur të kërkesës për informata shtesë dhe detyrimeve përkatëse lidhur me korrigjimin e dokumentacionit dhe zgjatjen e afatit.
- **Udhëzuesi Nr. 002/2024 – Pikat 7.1 dhe 7.2:** Për të drejtën e OE-së për të kërkuar sqarime dhe respektimin e afateve përkatëse.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ne, si Operator Ekonomik i interesuar për pjesëmarrje në aktivitetin e prokurimit me titull **„Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal"**, kundërshtojmë Njoftimin për Kontratë dhe kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit, pasi konsiderojmë se kriteret profesionale dhe teknike të vendosura nuk janë në përputhje me natyrën, vëllimin dhe përmbajtjen e punëve të parapara për realizim në kuadër të këtij aktiviteti të prokurimit!.

Njëkohësisht, kundërshtojmë edhe përgjigjen e Autoritetit Kontraktues të datës 13.11.2026, e cila nuk ka trajtuar në mënyrë konkrete çështjet e ngritura në kërkesën tona paraprake, duke mos dhënë përgjigje të veçanta dhe arsyetim për domosdoshmërinë e kritereve të kontestuara. Për më tepër, përgjigjja është kthyer me vonesë, duke kufizuar kohën në dispozicion për përgatitjen e ofertës dhe ushtrimin e të drejtave tona ligjore, rrethanë e cila ngre shqetësime në trajtim të barabartë dhe jo diskriminues.

FAKTET DHE ARGUMENTET

Pas analizimit të Dosjes së Tenderit, kemi vërejtur se një pjesë e konsiderueshme e kërkesave profesionale dhe teknike lidhen me punë të ndërtimit të lartë dhe një pjese të asfaltimit, edhe pse objekti i kontratës ka të bëjë me **sinjalizimin horizontal dhe vertikal**! Kjo ishte aryeja përse i kemi kërkuar Autoritetit Kontraktues sqarime lidhur me bazën ligjore dhe profesionale, domosdoshmërinë dhe ndërlidhjen e këtyre kritereve me natyrën e punëve të parapara.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktues është kufizuar në deklarimin se: **"Dosja e Tenderit është hartuar duke u bazuar në legjislacionin primar dhe sekondar të prokurimit publik, përmes së cilës janë krijuar kushtet dhe mundësitë për pjesëmarrje (ofertim/tenderim) të barabartë për të gjithë OE të interesuar."** Ky arsyetim është i përgjithshëm dhe nuk jep përgjigje konkrete për çështjet e ngritura, as nuk sqaron bazën ligjore dhe profesionale të kritereve të kontestuara.

Për më tepër, Autoriteti Kontraktues e ka trajtuar kërkesën tonë për sqarime si kërkesë për rishqyrtim/Ankesë, duke i cilësuar pyetjet tona si "**pretendime ankimore**" dhe si **tërësisht të pabazuara**, ndonëse kërkesa kishte për qëllim vetëm sqarimin e kritereve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Gjithashtu, vonesa në kthimin e përgjigjes ngre shqetësime lidhur me respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga neni 53 i LPP-së, pasi ka kufizuar kohën në dispozicion për ndërmarrjen e veprimeve të mëtejshme ligjore brenda afateve të përcaktuara. Për më tepër, AK-ja nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për zgjatjen e afatit për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertave, ndonëse një mundësi e tillë është e paraparë shprehimisht me legjislacionin në fuqi dhe mbështetet në nenin 24.5 të Rregullores për Prokurimin Publik. Si rrjedhojë, jo vetëm që nuk kemi marrë sqarimet e nevojshme për kriteret e përcaktuara, por as nuk na është mundësuar kohë shtesë për përgatitjen e ofertës pas përgjigjes së vonuar të AK-s

Lidhur me ISO standardet

Në kërkesën për sqarime kemi paraqitur pyetjen në vijim:

Përveç standardit ISO -9001-2015 I cili ka të bëjë direct me cilësin e punëve të kërkuara në paramasë, nuk po e kuptojmë nevojën për kërkimin e ISO-ve të tjera dhe lidhëshmërin e tyre me punët e specifikuara në paramasë.

Kërkojmë të sqarohet :

- ***Çfarë nevoje konkrete mbulojnë këto standard , dhe përse janë kerkuar në këtë dosje të tenderit, ju lutem të shpjegoni se cila do të ishte lidhëshmëria e tyre me implementimin e këtij projekti?***

Kjo pyetje është dashur të arsyetohet dhe të marrë përgjigje nga AK, por është trajtuar si ankesë. Fillimisht, theksojmë se, duke u bazuar në natyrën e punëve të parapara në paramasë, ISO 9001 ka lidhje të drejtpërdrejtë me projektin. Ndërkaq, nga pozicionet e paramasës nuk kemi vërejtur ndonjë punë me rrezikshmëri të lartë që do të kërkonte masa shtesë të sigurisë, sikurse në **projektet e ndërtimit të lartë**.

Përveç kësaj, Aneksi 1 – Specifikacioni Teknik nuk ekziston fare, rrjedhimisht nuk janë dhënë përshkrimet e punëve konkrete dhe mënyra se si duhet të zbatohen kërkesat e përshtatshmërisë teknike dhe profesionale. Andaj, konsiderojmë se ky kriter është vendosur pa u mbështetur në natyrën e punëve dhe pa u arsyetuar me dispozita konkrete të legjislacionit primar dhe sekondar.

Pasi që edhe nga AK nuk kemi marrë përgjigje konkrete lidhur me arsyetimin e përcaktimit të këtij kriteri, kërkojmë që i njëjti të ndryshohet dhe të hiqet.

Lidhur me kërkesën për sqarime për stafin profesional

Në kërkesën për sqarime kemi paraqitur pyetjen në vijim:

Megjithatë, në Dosjen e Tenderit nuk është shpjeguar se për cilat punë konkrete kërkohen:

- *Inxhinier i diplomuar i nderitmtarise me mbi 20 vite përvojë pune pas diplomimit , te jete i licencuar nga oda me licence A te jete i certifikuar per Fidik , IVS,specialist per organizimin dhe menaxhimin e kantiereve te ndertimit*
- *Inxhinier i diplomuar i gjeodezise ose bacheller i gjeodezis i licencuar nga AKK mbi 5 vite përvojë pune pas diplomimit , te jete i qertifikuar per siguri dhe shendet ne pune.*
- *inxhinier I diplomuar I ndertimtarise – ose bachelor - Konstruktiv min 3 vite pervoje pune pas diplomimit I certifikuar per menaxhimin e projekteve publike dhe eficiencen ne energji*
- *Inxhinier i mjedisit se paku 5 vite punë pas diplomimit i certifikuar si ekspert i sigurise dhe shendetit ne pune dhe nga AME, si auditor për ISO 14024-EKOLABELING*

Duke pasur parasysh se në paramasë nuk shohim punë të karakterit ndërtimor, konstruktiv, gjeodezik apo punë të tjera që kërkojnë këto profile, kërkojmë të na sqarohet:

- ***çfarë detyrash konkrete do të kryejë secili prej tyre gjatë realizimit të këtij kontrakti?***
- ***çfarë dëshmojnë certifikatat FIDIC dhe IVS dhe cila është lidhja e tyre me punët e parapara në këtë aktivitet (bazuar në hulumtimet tona çërtifikatra IËS është çertifikatë ekskluzivisht për saldim, ndërkaq IVS është ekskluzivisht çertifikatë e fushës së Ekonimisë konkretisht për tregjet ndërkombëtare të kapitalit)!? Për këto arsye ne kemi dyshime se cila çertifikat është kërkuar nga ana juaj dhe cila është arsyeja qe kërkohen këto çertifikata në implementimin e projektit? Ju lutem na shpjegoni se a është gabim teknik gjatë përpilimit të D.T.?***

Edhe këto pyetje kanë mbetur pa përgjigje, ndërsa AK i ka cilësuar si pretendime ankimore të pabazuara. Ne kemi kërkuar të sqarohet lidhja e këtyre profileve me natyrën e projektit, pasi kërkesat e përcaktuara janë më shumë të përshtatshme për punë ndërtimore ekskluzivisht nërtim të lartë dhe jo për sinjalizim horizontal dhe vertikal.

Sinjalizimi rrugor lidhet drejtpërdrejt me fushën e komunikacionit, ndërsa vendosja e vijave të bardha dhe montimi i shtyllave me shenja nuk kërkojnë angazhimin e inxhinierëve konstruktivë, siç do të ishte rasti në ndërtim të lartë. Po ashtu, nuk shohim ndërlidhje të profilit të inxhinierit të mjedisit he gjeodetit me punët e parapara në këtë projekt.

AK nuk ka dhënë asnjë arsyetim konkret që dëshmon domosdoshmërinë dhe ndërlidhjen e këtyre profileve me objektin e kontratës. Për më tepër, vonesa në dhënien e përgjigjes ndaj kërkesës sonë për sqarime, e ndjekur nga një përgjigje që nuk trajton çështjet e ngritura, e thellon mungesën e transparencës në këtë proces. Në mungesë të një arsyetimi objektiv, përcaktimi i këtyre profileve krijon kufizim të panevojshëm dhe arbitrar të konkurrencës, duke favorizuar operatorët ekonomikë që merren me ndërtim të lartë dhe duke vënë në pozitë të pafavorshme operatorët e specializuar në fushën e sinjalizimit.

Për të gjitha arsyet e lartcekura, kërkojmë largimin e këtyre kritereve nga Dosja e Tenderit, pasi vendosja e tyre pa ndërlidhje dhe arsyetim objektiv me natyrën e kontratës përbën shkelje të neneve 7, 28 dhe 29, si dhe nenit 69 të LPP-së, duke cenuar barazinë në trajtim, konkurrencën dhe përcaktimin

e kërkesave të përshtatshme teknike dhe profesionale. Njëkohësisht kërkojm që të mbetet në fuqi kërkesa për profilin e inzhinierit të komunikacionit i cili është i lidhur drejtëpërdrejtë me punët të sinjalizimit horizontal dhe vërtikal.

Lidhur me kërkesën për sqarime rreth pajisjeve të kërkuara

Në kërkesën tonë për sqarime dhe më vonë në kërkesën për rishqyrtim, kemi ngritur çështjen e domosdoshmërisë së pajisjeve të kërkuara

Në listën e pajisjeve kërkohen, ndër të tjera, këto makineri dhe pajisje:

- *Cilinder gom gom max 3t*
- *Një(1) Damper 2000Kg me kove shkarkuese(vetshkarkues) dhe eskavator(krahun per ngarkim) si dhe nivelizues (thike per rrafshim) I regjistruar me libreze valide*
- *Rrethoja për sigurinë e vendpunishtes me shenja trafiku dhe sinjalizues me drita led min 100m*
- *Një(1)makine per prerje asfalti*
- *Një(1) Gjysemrimorkio me libreze valide*
- *Një(1) Eskavator dhe qekiq.*

Nuk po arrijmë të kuptojmë se për çfarë pune konkrete janë të domosdoshme këto pajisje në një procedur ku sipas paramasës, parashihen vendosja shenjave të trafikut (trekëndëshe, rrethore dhe drejtkëndore), vendosja e vijave informuese në rrugë, shënjim i vendkalimeve për këbësorë. Punim i ishujve, punim i shiroitave tërthor

Duke pasur parasysh se në paramasë nuk janë paraparë punë që kërkojnë përdorimin e këtyre pajisjeve, kërkojmë të na sqarohet:

- *Për çfarë qëllimi kërkohet cilindri i gomës; maksimum 3 tonë, kur në paramasë nuk janë paraparë punë të ngjeshjes së tokës apo të sipërfaqeve?*
- *Për çfarë pune konkrete nevojitet damperi 2,000 kg me kovë vetëshkarkuese, krah për ngarkim dhe thikë për rrafshim, kur nuk janë paraparë punë të ngarkimit, transportimit apo nivelizimit të dheut?*
- *Për çfarë nevoje kërkohen rrethojat për sigurinë e vendpunishtes me shenja trafiku dhe sinjalizues me drita LED, në gjatësi minimale prej 100 metrash, dhe mbi çfarë baze është përcaktuar kjo gjatësi?*
- *Për çfarë qëllimi kërkohet makina për prerje të asfaltit, kur në paramasë nuk është paraparë ndonjë pozicion që përfshin prerjen e asfaltit, gjthashtu ky është projekt për sinjlaizim dhe jo për ndërtimin e rrugëve me asfalt?*
- *Cili është funksioni konkret i gjysmë-rimorkios me librezë valide dhe si lidhet nevoja për të me realizimin e punëve të parapara në këtë kontratë?*

Gjithashtu kërkojm që të na ofrohet një sqarim përse nuk janë këruar pajisjet që janë të domosdoshme për kryerjen dhe implementimin e projekteve të sinjalizimit rrugorë (horizontal dhe vërrtikal) por janë kërkuar pajisje të cilat janë ekskluzivisht për shtrimin dhe asfaltimin e rrugëve

Kemi kërkuar të sqarohet se për çfarë punësh konkrete nevojiten këto pajisje, kur në paramasë parashihen vetëm punët e sinjalizimit horizontal dhe vertikal. Për më tepër, për këto punë përdoren pajisje të tjera. Në vend të rrethojave për siguri, duhet të kërkohen kona për ngadalësimin e shpejtësisë. Në vend të pajisjes për prerjen e asfaltit, duhet të kërkohen pajisje për aplikimin e ngjyrës njëkomponentëshe ose dykomponentëshe. Ndërsa, për gjysmë-rimorkion dhe eskavatorin me çekan, nuk ka asnjë funksion në kryerjen e punëve sipas përshkrimit në paramasë. Me fjalë të tjera asnjë nga paisjet e lartëpërmenduar në kërkesën ton për sqarime dhe kërkesën tonë për rishqyrtim nuk janë të lidhura drejtëpërdrejtë me punët e kërkuara në paramasë.

Për këtë arsye kemi kërkuar edhe të na sqarohet pse nuk janë kërkuar pajisjet e domosdoshme për implementimin e projekteve të sinjalizimit rrugor horizontal dhe vertikal, por janë kërkuar pajisje që përdoren kryesisht për shtrimin dhe asfaltimin e rrugëve si dhe ndërtim të objekteve të larta.

Këto mospërputhje na kanë ngritur dyshime se kërkesat janë përcaktuar për t'iu përshtatur operatorëve që merren me punë ndërtimore, përfshirë seperim dhe ndërtim të lartë, e jo operatorëve të specializuar në sinjalizim rrugor. Pikërisht për këtë arsye kemi kërkuar sqarime, duke mos dashur të paragjykojmë veprimet e AK-së pa marrë fillimisht një arsyetim për kriteret e vendosura. Megjithatë, AK nuk ka dhënë përgjigje konkrete dhe nuk ka dëshmuar mbi çfarë baze i ka konsideruar këto pajisje të domosdoshme për kontratën. Kjo gjë na lë në dyshim se AK qëllimisht ka ndërmarrë këtë veprim dhe është fokusuar në natyrën e punëve të ndërtimit të lartë dhe ndërtimit /asfaltim të rrugëve, duke kërkuar punëtorë dhe pajisje specifike për këto veprimtari, të cilat nuk kanë ndërlidhje me realizimin e punëve të sinjalizimit horizontal dhe vërtikal.

Pas të gjitha këtyre arsyetimeve, ne kërkojmë që këto kritere, të cilat i përkasin një fushe krejtësisht ndryshe nga sinjalizimi horizontal dhe vertikal, të hiqen dhe të zëvendësohen me kritere që lidhen drejtpërdrejt me natyrën e kontratës, përkatësisht me pajisjet dhe kapacitetet e nevojshme për realizimin e sinjalizimit rrugor horizontal dhe vertikal.

Lidhur me kërkesën për sqarime reth punëtorve- stafi teknik

Në kërkesën për sqarime e dërguar me datën 09.11.2026 kemi kërkuar :

Në dosje kërkohet angazhimi i së paku 11 punëtorëve me profile të ndryshme, përfshirë:

- *Nje (1) teknik per komunikacionin rrugor i diplomuar*
- *Dy (2) teknik të ndërtimtarisë !*
- *Një (1) teknik I makinerisë si dhe punëtor të trajnuar*
- *Një (1) punetor i çertifikuar per drenazhim !*
- *Dy (2) puntore te certifikuar per mbrojtje te ambientit !*
- *Një (1) ekspert për dhënien e ndihmës së parë dhe ndërhyrjen në emergjenca !*
- *Një (1) operatore te certifikuar per autovinc!*
- *Dy punëtor te certifikuar me ISO 9001 2008 per menagjim te cilesise dhe punëtorë të tjerë Teknik!*

Duke iu referuar paramasës, nuk po arrijmë të kuptojmë se për cilat pozicione të punës nevojiten të gjithë këta punëtorë, kur në paramasë nuk është paraparë asnjë punë e tillë? Kjo pjesë paraqet konfuzion se cilat punë do të realizohen me këta punëtorë- me këto kritere kualifikuese të këruara?

Kërkojmë të sqarohet:

- ***çfarë pune konkrete do të kryejë secili profil dhe mbi çfarë baze është përcaktuar numri minimal prej 11 punëtorësh për këtë aktivitet?***

Nuk e kishim të qartë se për çfarë nevojitet punëtori për **drenazhim**, kur drenazhimi zakonisht bëhet në ndërtim të lartë për të mos lejuar akumulimin e lagështisë. Te sinjalizimi rrugor nuk kemi të bëjmë me lagështi. E njëjta vlen edhe për teknikun e ndërtimit, kur ne kemi të bëjmë vetëm me sinjalizim dhe jo me ndërtimtari. Pa hyrë në detaje për profilet e tjera të kërkuara, të cilat po ashtu i përkasin natyrës së punëve të ndërtimit të lartë, po theksojmë se këtu kemi të bëjmë me sinjalizim rrugor dhe këto kritere nuk i takojnë natyrës së punëve që janë parapa të bëhen, dhe që janë sinjalizim horizontal dhe vertikal.

Nuk po flasim vetëm për nenin që rregullon Dosjen e Tenderit dhe specifikimet teknike neni 28 dhe 29, të cilat, përveçse janë të përcaktuara në LPP, janë shtjelluar edhe më qartë dhe më detajisht në Rregullore dhe Udhëzime Administrative. Po e ritheksojmë se Dosja e Tenderit duhet të përpilohet në atë mënyrë që të mos jetë e pafavorshme për operatorët ekonomikë të interesuar në fushën e caktuar. Neni 7 i LPP-së, po ashtu, kërkon që AK të mos jetë diskriminuese dhe të mos kufizojë konkurrencën.

Duke marrë parasysh të gjitha këto, kërkojmë që edhe kriteret e përcaktuara për punëtorët të hiqen, pasi nuk kanë të bëjnë me natyrën e punëve të sinjalizimit rrugor.

Lidhur me mos përgaditjen e Ankesit 1 dhe lidhja me paramasën

të cilën e kemi shtjelluar edhe ne kërkesë për sqarime dhe më vonë në kërkesën për rishqyrtim ku paqartësit tona ishin si më poshtë

Duke pasur parasysh se në Aneksin 1, nuk është paraqitur ndonjë përshkrim konkret i aktiviteteve, kërkojmë nga AK që ta plotësojë këtë pjesë, në mënyrë që OE të kenë një pasqyrë të qartë të punëve që parashihen të realizohen në kuadër të këtij kontrakti.

Në këtë drejtim, kërkojmë të na sqarohet:

- ***A parashihen në kuadër të këtij aktiviteti edhe punë të tjera, përveç atyre të paraqitura në paramasë?***
- ***Nëse po, cilat janë këto punë dhe pse nuk janë përshkruar në Aneksin 1?***
- ***Si ndërlidhen kërkesat për stafin profesional, punëtorët, pajisjet dhe certifikatat ISO me këto aktivitete?***

Bazuar në praktikat që rrjedhin nga legjislacioni për prokurimin publik në Kosovë Aneksi 1 duhet të shërbej për t'i vendosur të gjitha tiparet e punëve të parapara në paramasë dhe ndërlidhjen e saj me kërkesat në DT. Nga dosja e përpiluar nga ky AK , për kryerjen e pozicioneve të vendosjes së shenjave të trafikut, duhet një teknik për drenazhim, 2 inxhinierë të diplomuar të ndërtimit, drejtimi konstruktiv, dhe një inxhinier për mbrojtjen e ambientit së bashku me një teknik për mbrojtjen e ambientit, paisja e përdorur për këtë pozicion është ekskavator me çekan. Ndërsa për punët e parapara në paramasë ku parashihet punimi i vijave të ndalimit dhe shigjetave në rrugë, a nevojitet po i njëjti staf i lartpërmendur ose eksperti për siguri dhe mbrojtje në punë? Duke i vendosur para vendpunishtes rrethojat metalike dhe duke përdorur makinën për prerje të asfaltit? Nëse ne fillojmë t'i ndërlidhim punët e parapara në paramasë – vendosjen e shenjave të trafikut (trekëndëshe, rrethore dhe drejtkëndore); punimin e vijave të bardha gjatësore dhe të ndërprera në rrugë; punimin e vijave të ndalimit dhe shigjetave orientuese; shënjimin e vendkalimeve për këmbësorë me bazë të kuqe dhe shirita të bardhë; punimin e ishujve orientues për automjete; punimin e shiritave tërthorë

akustikë (dridhës) – me mjetet dhe punëtorët të cilët i ka kërkuar AK, nuk është e nevojshme të hyjmë në detaje për secilën punë veç e veç, sepse kriteret e kërkuara në këtë DT po dominojn të jenë jo profesional. Këto kërkesa nuk rezultojnë të arsyetuara në raport me natyrën e punëve të parapara paramasë.

Jemi në dijeni se secili AK ka një ekip profesional që është në gjendje të dallojë punët ndërtimore nga ato të sinjalizimit, punët e shërbimeve apo të furnizimit. Prandaj, edhe pas arsyetimit tuaj, me të cilin keni bërë përpjekje që kërkesën tonë për sqarime ta trajtoni si ankesë, vetëm për të mos iu përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga ne dhe për t'iu shmangur çështjes së neneve të ligjit mbi të cilat jeni mbështetur gjatë përpilimit të kritereve, vetëm për mos të na jeni sqarimet e kërkuara.

Punët në fushën e sinjalizimit dallojnë nga punët ndërtimore. Për rrjedhojë, nga përgjigjja e AK krijohet bindja se kjo procedurë është përgatitur në mënyrë të tillë që t'u përshtatet operatorëve ekonomikë që i përmbushin kriteret për ndërtim të lartë dhe jo atyre që merren me sinjalizim. Kjo qasje paraqet trajtim diskriminues ndaj operatorëve ekonomikë të specializuar në fushën e sinjalizimit dhe ngre dyshime për kufizimin e konkurrencës. Në këto rrethana, kërkojmë të sqarohet se në cilat dispozita të legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit publik AK është mbështetur për përcaktimin e këtyre kritereve.

Nuk mund të lëmë anash as vërejtjen se për një përgjigje sqaruese lidhur me pyetjet tona është dashur të presim pesë ditë, për të marrë më pas një përgjigje dhe atë të gabuar. Pasi që shihet qartë qe AK ka devijuar kërkesën ton për sqarime duke e trajtuar atë si kërkesë për rishqyrtim- dhe ose ankëse. Kjo tregon mungesë profesionalizmit. Për më tepër, po të ishte fjala për kërkesë për rishqyrtim, afati ligjor i paraparë për trajtimin e saj është tre ditë. Kjo ngre dyshime serioze se një veprim i tillë është ndërmarrë në mënyrë tendencioze, me qëllim të humbjes së të drejtave tona që na takojm ligjerisht. Duke u mbështetur në atë se na është humbur koha në mënyrë të qëllimshme pasiqë është ditur që përgjigja amatere e AK do të na nxiis neve të drejtohem me kërkesë për rishqyrtim. Dhe kjo mundësi na është kufizuar

Për më tepër në rast se sqarimet e kërkuara janë paraqitur mbreda aftit kohor që ka qenë i paraparë në DT Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar ta zgjasë këtë afat, në përputhje me nenin 24.5 të Rregullores për Prokurimin Publik. Mosveprimi në këtë drejtim ka kufizuar kohën në dispozicion për përgatitjen e ofertave dhe ka cenuar mundësinë për konkurrim efektiv.

Gjithashtu, dëshirojmë të theksojmë se ne nuk kemi kërkuar përgjigje joformale dhe gjithëpërfshirëse, por të argumentuar me dispozitat përkatëse ligjore, si dhe me natyrën e punëve të parapara në paramasë, për të sqaruar arsyet e vendosjes së këtyre kritereve, të cilat duhet të kenë lidhje të drejtpërdrejtë me natyrën e punëve të parapara në paramasë – që kanë të bëjnë me sinjalizim dhe jo ndërtim.

Nga të gjitha rrethanat e paraqitura më lart, rezulton se AK nuk i ka respektuar dispozitat e legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit publik.

* * *

Prandaj, duke marrë parasysh të gjitha çështjet e ngritura më lart, kërkojmë nga OSHP që të marrë për bazë këtë ankesë dhe të ndërmarrë Vendim si në vijim:

- Te shqyrton te gjitha pretendimet e ANKESES, te bien Vendimin meritor duke u bazuar ne faktet dhe argumentet e paraqitura me larte, si dhe te nxjerrë VENDIM për eliminimin e shkeljeve te bëra gjate përgatitjes se Dosjes se tenderit e sidomos te Specifikave teknike dhe te dëshmive te kërkuara;
- Të korrigjohet dokumentacioni i tenderit në pjesët e kontestuara;
- Të eliminohen kriteret kufizuese dhe diskriminuese që nuk burojnë nga Paramasa dhe Parallogaria;
- Të harmonizohen FDT, Specifikimet Teknike, Paramasa dhe Aneksi 7;
- Të ipen sqarime të plota dhe të arsyetuara lidhur me çështjet e ngritura në kërkesën tonë për sqarime;
- Me rastin e RI-VLERESIMIT, Paneli Shqyrtues të kërkojë nga AK – Zubin Potok qe te zbaton ne plotësi kërkesat e LPP, e sidomos:
- Nenin 7: Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi
- Nenin 6: Ekonomiciteti dhe Efikasitet
- Neni 27 : Dosja e Tenderit

- Neni 28: Specifikimet Teknike
- Neni 51: Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes

Duke patur një besim te plotë në OSHP, shpresojmë se Ankesa e jonë do të vlerësohet drejtë, dhe në përputhje me Nenin 1 te LPP: Qëllimi i Ligjit.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet kryesore te cilat i janë shkaktuar OE - Traffiks va SH.P.K

- Mohimi i te drejtës për ta paraqitur një ofertë te arsyeshme per shkak te kërkesave diskriminuese dhe te përgatitura ne mënyrë te njëanshme për një OE te paracaktuar;
- Ulja e kredibilitetit te kompanisë sonë
- Shpenzimet e resurseve humane dhe financiare për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës;
- Ngarkesat psikike dhe shqetësimet te cilat ne vazhdimësi na përcjellin me rastin e padrejtësive qe na ka shkaktuar AK;
- Humbja e besimit për te tenderuar ne aktivitetet tjera te prokurimit, edhe me këtë zvogëlimin e konkurrencës dhe mos-arritjen e vlerës për para nga ana e AK

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*